



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT ZËDHËNËSI

06.06.2016

### BASHKIA PËRMET

#### **KLSH Kallëzon në Prokurori 3 anëtar të KVO-së në Bashkinë Përmet, për shkelje të barazisë në procedurat e prokurimit dhe favorizimi i operatorëve duke i shkaktuar shtetit dëm në vlerën 11 milionë lekë**

Kontrolli i Lartë të Shtetit, në zbatim të programit të tij të auditimit nr. 997/1 prot, datë 03.11.2015, ka përfunduar auditimin në Bashkinë Përmet, me objekt: “Auditimi i zbatimit të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare për vitet 2013 - 2015”.

Me Vendimin nr. 18, datë 29.02.2016 të Kryetarit të KLSH-së është miratuar Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe për përmirësimin e gjendjes, me shkresë nr. 997/9, date 29.02.2016 i janë rekomanduar Bashkisë Përmet masa me karakter organizativ, dhe shpërblimin e demit të shkaktuar në vlerën totale 11 milion lekë.

Gjatë auditimit u konstatuan disa shkelje dhe parregullsi të dispozitave ligjore në fuqi. Në përgjithësi këto shkelje e parregullsi, konsistojnë një sërë shkeljesh të dispozitave përkatëse ligjore e nënligjore gjatë ushtrimit të detyrës, në fushën e zbatimit të procedurave të prokurimit publik lidhur me vlerësimin e ofertave ekonomike në procedurat e prokurimit me objekt: “*Rikonstruksioni i trotuareve në bllokun e qendrës qyteti, Përmet*”. Konkretisht:

Nga krahasimi i ofertës ekonomike të dy prej operatorëve ekonomike rezultoi se të dy këta ofertues kanë paraqitur kontratë furnizimi guri me të njëjtën shoqëri furnizuese, dokumentacioni tekniko-ligjor i të cilës është i njëjtë për të dyja kontratat e lidhura.

Për rrjedhojë KVO në vlerësimin e ofertave të këtyre operatorëve ekonomikë ka aplikuar një standard të dyfishtë, duke e vlerësuar këtë kriter si një kriter të vlefshëm dhe në pajtueshmëri me kërkesat e AK për operatorin konkurrues me ofertë ekonomike me të lartë dhe në papajtueshmëri për operatorin konkurrues me ofertë ekonomike me të ulët.

Vlerësimi i KVO është në kundërshtim me nenet 20, 46, 53 të Ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, dhe Kreu-t V të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, pasi ka Skualifikuar ofertues të cilët plotësojnë kriteret për kualifikim duke përdorur dy standarde gjatë vlerësimin të ofertave, si rrjedhojë me përzgjedhjen e ofertës fituese autoriteti kontraktor ka paguar më shumë në vlerën 7.1 milion lekë.

KLSH, duke i konsideruar veprimet e kryera nga **V.P. J.P.** dhe **D.D.** (në cilësinë e anëtarëve të KVO) në procedurën e prokurimit “*Rikonstruksioni i trotuareve në bllokun e qendrës qyteti, Përmet*”, si veprime me pasoja të rënda për interesat e ligjshme të shtetit dhe të dënueshme sipas ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995 “*Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*”, me shkresën nr. 997/15, date 31.05.2016, ka bërë kallëzim pranë Prokurorisë së Rrethit Gjirokastrë, Përmet, për shkelje të barazisë në vlerësimin e ofertave gjatë procedurës së prokurimit, duke i shkaktuar buxhetit të shtetit dëm ekonomik në vlerën 11.1 milionë lekë, dhe për pasojë ka konsumuar elementët e figurës së veprave penale të “*Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tender apo ankande publike*” parashikuar nga nenet 258 të Kodit Penal.

V.O. Në Web-in e KLSH gjendet i plotë Vendimi nr. 18, datë 29.02.2016 në lidhje me këtë auditim.